



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura III

Seancë plenare e Kuvendit të Kosovës

P- 019

Prishtinë, më 20 maj 2008, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
20 MAJ 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Eqrem Kryeziu**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 99 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Shqyrtimi i parë i Grupit të tretë të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, sipas procedurës së veçantë:

- 1.1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës,
- 1.2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë,
- 1.3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
- 1.4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror,
- 1.5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për azil, dhe
- 1.6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës.

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit se ky projektligj iu është shpërndarë deputetëve më 19 maj 2008 dhe në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Kryetari ftoi ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, që në emër të Qeverisë ta prezantojë Projektligjin.

Ministri **Enver Hoxhaj** tha se qëllimi themelor i këtij projektligji është rregullimi i arsimit në nivelin parafillor, fillor dhe të mesëm në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.

Projektligji, po ashtu, rregullon edhe kompetencat dhe përgjegjësitë që i ka Ministria e Arsimit në fushën e hartimit të politikave dhe të legjislacionit në fushën e organizimit të arsimit formal dhe joformal, në fushën e rregullimit të cilësisë në arsim dhe të monitorimit të arsimit.

Ky projektligj rregullon çështjet që kanë të bëjnë me kompetencat e komunave dhe sidomos me kompetencat e zgjeruara të komunave, ku ndër të tjera hyn edhe çështja e regjistrimit dhe të pranimi të nxënësve, pranimi i personelit mësimor, i mësimdhënësve dhe i personelit tjetër administrativ në shkolla, çështja e zgjedhjes së menaxhmentit shkollor, të drejtorëve dhe të zëvendës drejtorëve, çështjet e shëndetit të nxënësve dhe çështjet e tjera, që ndërlidhen me arsimin fillor dhe të mesëm.

Ndër çështjet e tjera që rregullon ky ligj është edhe çështja e arsimit në gjuhën serbe, ku ndër të tjera rregullohet edhe çështja e organizimit të mësimi në gjuhën serbe, të plan-programeve shkollore, të kompetencave të zgjeruara për komunën e Mitrovicës së veriut, si dhe çështjet e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë.

Ligji ka 6 kapituj dhe 17 nene, buron nga Pakoja e Ahtisarit dhe është në përputhje me legjislacionin evropian.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, në parim.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se e mbështet Projektligjin për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës.

Agim Veliu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deklaroi se mbështesin në parim Projektligjin për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, kurse vërejtjet do t'i paraqesin në Komisionin ad hoc.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se mbështesin Projektligjin për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës.

Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se mbështesin në parim Projektligjin për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës.

Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar "7+", tha se e mbështet miratimin e Projektligjin për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës.

Bojan Stojanović, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se e mbështet në parim miratimin e Projektligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, kurse vërejtjet dhe sugjerimet do t'i paraqesin në Komisionin ad hoc.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij pprojektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----68,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

Zëvendëskryeministri **Ramë Manaj** tha se me këtë projektligj parashihet themelimi i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

Inteligjenca dhe kundërinteligjenca janë mjet i fuqishëm dhe i domosdoshëm për të parandaluar çdo lloj kërcënimi nga brenda dhe nga jashtë: terrorizmin ndërkombëtar apo vendor; prodhimin dhe trafikimin e narkotikëve; krimin e organizuar; krimin ekonomik; sabotimin dhe të gjitha çështjet e tjera të cilat kanë ndikim direkt për sigurinë e Kosovës.

Me këtë projektligj përcaktohet përdorimi i të gjitha mjeteve të arsyeshme dhe të ligjshme, të cilat duhet të përdoren për të siguruar që Kosova të pranojë informatat më cilësore të inteligjencës. Projektligji parasheh mbledhjen, analizën dhe shpërndarjen e të gjitha informatave nga fusha e inteligjencës, në mënyrë të shpejtë dhe të përgjegjshme.

Dispozitat e këtij projektligji respektojnë parimet e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Themelore të Njeriut dhe parimet e tjera relevante të pasqyruara në instrumentet ligjore të njohura ndërkombëtarisht dhe garanton kryerjen e aktiviteteve të Agjencisë për Inteligjencë në pajtueshmëri me to.

Presidenti i Republikës së Kosovës, së bashku me Kryeministrin e Republikës së Kosovës, emërojnë drejtorin, zëvendësdrejtorin dhe inspektorin e përgjithshëm të Agjencisë.

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë do të ketë përbërje dhe strukturë drejtuese profesionale dhe apartiake.

Puna e Agjencisë i nënshtrohet kontrollit parlamentar.

Agjencia nxjerr rregullore për organizimin e brendshëm, si dhe do të ketë kodin e etikës.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Rrustem Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se e mbështet në parim Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deklaroi se mbështesin në parim Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, por paraqiti disa vërejtje në nenet 29, 32, 35 e 34, të cilat duhet t'i shqyrtojë Komisioni ad hoc.

Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se mbështesin Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë. Ai paraqiti vërejtje në nenin 24.7 të Projektligjit.

Lilzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se mbështesin në parim Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar "7+", tha se e mbështet miratimin e Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

Bojan Stojanović, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se e mbështet në parim miratimin e Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, por kërkoi nga Qeveria që me akt nënligjor ta rregullojë edhe përfaqësimin e kadrove të bashkësive etnike në kuadër të kësaj agjencie.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----78,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

Zëvendëskryeministri **Ramë Manaj** tha se kjo lëmi deri më tani është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/12 - Rregullore mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, kurse me ndryshimin e statusit të Kosovës, është e nevojshme që kjo fushë të rregullohet me ligj.

Me këtë projektligj zëvendësohet Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit me institucion të ri pasardhës, pra me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Agjencia e Privatizimit ka autoritet për të privatizojë ndërmarrjet në pronësi shoqërore ende të paprivatizuara, në pajtim me Kushtetutën e vendit dhe me Propozimin e Ahtisarit për zgjedhjen e statusit.

AKM do të shndërrohet në AKP.

Projektligji ka 7 kapituj dhe 32 nene. Kapitulli i parë rregullon statusin ligjor, qëllimet dhe përkufizimet, kapitulli i dytë rregullon detyrat dhe kompetencat e agjencisë, kapitulli i tretë rregullon organizimin dhe menaxhimin, i katërti rregullon dispozitat financiare, kapitulli i pestë rregullon përgjegjësinë dhe komisionet shqyrtuese, kapitulli i gjashtë rregullon zbatimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe kapitulli i shtatë, i fundit, rregullon dispozitat përfundimtare.

Projektligji është në harmoni të plotë me kërkesat themelore të BE-së mbi transparencën dhe jodiskriminimin.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se e mbështet në parim Projektligjin për Agjencinë e Privatizimit.

Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deklaroi se mbështesin në parim Projektligjin për Agjencinë e Privatizimit. Ai sugjeroi që kjo agjenci të financohet edhe nga fondi i privatizimit.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se mbështesin Projektligjin për Agjencinë e Privatizimit.

Berim Ramosaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se mbështesin në parim Projektligjin për Agjencinë e Privatizimit. Ai pati vërejte në nenet 12.2 dhe 14.9 lidhur me përbërjen e Bordit të Agjencisë dhe të kompetencave të anëtarëve ndërkombëtarë.

Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, tha se e mbështet miratimin e Projektligjin për Agjencinë e Privatizimit.

Bojan Stojanović, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se e mbështet në parim miratimin e Projektligjin për Agjencinë e Privatizimit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----74,
Kundër----- 5,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për Agjencinë e Privatizimit.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

Ministri **Zenun Pajaziti** tha se nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji është e një rëndësie të madhe për faktin se e bën rregullimin ligjor të menaxhimit të integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror.

Ky projektligj adreson çështjet që kanë të bëjnë me organet kompetente që janë të ngarkuara me përgjegjësi për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror, me bashkëpunimin e policisë kufitare me agjencitë e tjera në kufi, me qëllim të sigurimit të pacenueshmërisë së kufirit. Mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, parandalimin e migrimit ilegal, zbulimin dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale dhe arrestimin e kryerësve të tyre, ndalimin e kontrabandimit të mallrave dhe bashkëpunimin në fushën e përgjegjësi dhe të autorizimeve të organeve shtetërore, si dhe kushtet për mbikëqyrjen dhe zbatimin e tij.

Projektligji ka tetë kapituj me gjithsej me 38 nene dhe është në harmoni me legjislacionin e BE-së dhe parimet në bazë të aquis-comunitaire.

Për zbatimin e këtij projektligji nevojiten mjete buxhetore, por edhe krijohen të hyra për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror.

Rrustem Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se e mbështet Projektligjin për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deklaroi se mbështesin në parim Projektligjin për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror.

Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se mbështesin Projektligjin për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror.

Gani Geci, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se mbështesin në parim Projektligjin për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror.

Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, tha se e mbështet miratimin e Projektligjin për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror.

Bojan Stojanoviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se e mbështet në parim miratimin e Projektligjin për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----69,

Kundër----- 3,

Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për azil

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

Ministri **Zenun Pajaziti** tha se nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji është e një rëndësie të madhe për faktin se bën rregullimin ligjor të të gjitha çështjeve që ndërlidhen me personat të cilët kërkojnë azil, përcakton afatet kohore për themelimin e Qendrës së Azilit në Kosovë dhe përshkruan në vija kryesore procedurat nga kjo lëmi.

Qëllimi i këtij projektligji është vendosja e rregullave ligjore lidhur me çështjet e refugjatëve, të azilkërkuesve, të personave nën mbrojtje plotësuese dhe të atyre nën mbrojtje të përkohshme, të cilët kërkojnë mbrojtje në Republikën e Kosovës.

Me qëllim të krijimit të një kornize ligjore për rregullimin e çështjeve të azilit dhe të refugjatëve në Republikën e Kosovës, kriteret e njohjes së azilit, të drejtat dhe detyrimet e refugjatëve dhe rregullimin e procedurave nga kjo lëmi, Ministria e Punëve të Brendshme ka hartuar Projektligjin për azil në Republikën e Kosovës.

Projektligji adreson çështje që kanë të bëjnë me: njohjen e azilit, ndërprerjen e tij, bashkëpunimin e organeve shtetërore me Zyrën e UNHACER-it, organet kompetente për azil, parimin e dyshkallshmërisë brenda procedurës administrative, si dhe kategoritë përfituese nga njohja e azilit.

Projektligji ka 9 kapituj me gjithsej 73 nene dhe është në harmoni me legjislacionin e BE-së.

Për zbatimin e këtij projektligji nevojiten mjete nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për azil, në parim.

Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se e mbështet Projektligjin për azil.

Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deklaroi se mbështesin në parim Projektligjin për azil.

Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deklaroi se mbështesin Projektligjin për azil. Ai pati vërejtje në nenin 8 të projektligjit, për të cilin tha se është tepër liberal.

Besa Gaxheri, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se mbështesin në parim Projektligjin për azil.

Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, tha se e mbështet miratimin e Projektligjin për azil.

Bojan Stojanović, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se e mbështet në parim miratimin e Projektligjin për azil.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij pprojektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----80,
Kundër----- 3,
Abstenime----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për azilin.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

Ministri **Arsim Bajrami** tha se me këtë projektligj krijohet baza ligjore për rregullimin e festimit të festave zyrtare, ngase deri më tani kjo materie është rregulluar me një akt nënligjor.

Projektligji del nga Pakoja e Ahtisarit dhe iu ka nënshtruar procesit gjithëpërfshirës të miratimit, duke përfshirë fazat dhe procedurat e veçanta.

Ministria e Shërbimeve Publike një kohë të gjatë ka punuar në këtë projektligj dhe në versionin zyrtar ne e kemi propozuar një numër më të madh të festave zyrtare, duke përfshirë edhe 28 Nëntorin, 5 Marsin dhe një varg festash të tjera dhe ia kemi proceduar këtë projektligj Grupit gjithëpërfshirës, për miratim dhe për shqyrtim.

Projektligji parasheh tre lloj festash zyrtare në Republikën e Kosovës: festat zyrtare, festat kombëtare apo memoriale dhe festat komunale.

Ligji në nenin 5 parasheh që Qeveria e Kosovës do të formojë Komisionin Republikan të Festave, i cili do të përcaktojë interiaren dhe mënyrën e festimit të festave.

Qeveria e Kosovës, me një vendim të veçantë do të përcaktojë festat kombëtare dhe festat memoriale dhe mënyrën e festimit dhe pa dyshim festa e 28 nëntorit është një festë kombëtare që do të festohet nga i tërë kombi shqiptar. Ndërkaq, ligji përcakton festat shtetërore.

Gjithashtu ligji përcakton edhe festat komunale dhe autorizon kuvendet e komunave që me aktet e tyre nënligjore të përcaktojnë festat komunale dhe të përcaktojnë mënyrën e festimit të tyre.

Në pjesën teknike, Ligji rregullon mënyrën e festimit të festave dhe përcakton ditët e pushimit, ditët e kremtimit, duke përcaktuar edhe kompensimin me pagesë gjatë ditëve të festave, por edhe duke u obliguar që shërbimet emergjente edhe gjatë ditëve të festave të punojnë.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, në parim.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se do ta mbështesin në parim këtë projektligj, vetëm me mundësinë që të shtohen edhe tri data, që janë: Dita e Flamurit Kombëtar, Dita e Çlirimit dhe Dita e Dëshmorëve.

Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, mbështeti parafolësin nga GP i PDK-së që në Projektligj të përfshihen edhe tri festat e cekura më lart. Ai propozoi që titulli i projektligjit të jetë: “Festat zyrtare të Republikës së Kosovës”. Ai listoi festat që parashihen me nenin 2.1 të Projektligjit dhe propozoi që pjesa e parë e tij të riformulohet dhe të ketë parasysh: traditën, historinë dhe kulturën e popullit të Kosovës.

Ardina Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, mbështeti dy parafolësit lidhur me këtë projektligj. Ai shtoi se Qeveria nuk duhet t’i shpallë festat me ndonjë vendim të vetin, por ato duhet t’i shpallë Kuvendi.

Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se mbështet qëndrimet e përfaqësuesve të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe të atij të LDK-së dhe kërkoi që ato t’i mbrojnë edhe gjatë shqyrtimit të dytë të projektligjit.

Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, tha se e përkrah në parim këtë projektligj, por kontributin dhe vërejtjet lidhur me komunitetet do t’i japim në Komisionin ad-hoc.

Bojan Stojanović, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se mbështet Projektligjin për festat zyrtare me një vërejtje lidhur me datën e festimit të Krishtlindjeve ortodokëse. Nëse në Projektligj shtohen edhe festa të tjera, atëherë do ta marrim vendim lidhur me to.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij pprojektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----54,
Kundër----- 6,
Abstenime----- 14.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për festat zyrtare në Republikën e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin ad hoc, që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 11:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale